

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“CONSTRUCTION TECHNOLOGY” sh.p.k

Me anë të këtij Akti-Themelimi, UNË ORTAKU I

Shoqërisë ““CONSTRUCTION TECHNOLOGY” sh.p.k

VENDOSA

Të themelojmë Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar, emërtimi I plotë I së cilës është:

“CONSTRUCTION TECHNOLOGY” sh.p.k

NENI 1

Shoqëria emërtohet “CONSTRUCTION TECHNOLOGY” sh.p.k

Shoqëria është person juridik I së drejtës shqiptare dhe zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar si edhe dispozitat e Statutit dhe këtij Akt-Themelimi. Shoqëria do të quhet person juridik dhe do të veprojë si e tillë duke filluar nga dita e rregjistrimit të saj në Q.K.B ndërsa veprimtaria ekonomike fillon me rregjistrimin e saj në Organet Tatimore.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe m bulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë.

Kapitali minimal

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ka një kapital prej 100 000 lekë I cili është I perbere nga 1(nje) kuota.. Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar zotërohet nga një person qe është edhe Ortaku I Vetem I Shoqerise. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;



- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Nësë shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku I vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investimeve;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.


Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund tikundrejtojë pavlefshmërisë të tretit, që kafitur të drejtan e mirëbesim, përvec rastit kur shoqëria provon se I treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 2 OBJEKTII SHOQËRISË

Objekti I veprimtarisë së SHOQËRISË është:

- Import -- Eksport. •Materiale dhe Produkte te Ndryshme Te Fushes Wellness & Estetike,Hidrosanitare etj,Ndertim :Prodhim Pishinash,Sauna,Vaska Hidromasazhi,Dhoma Kripe,BanjoTurke,Dushe emocionle,Dushe Skoceze,Dushe Akulli si dhe Prodhime Produktesh te tjera te Fushes Wellness & Estetike,Hidrosanitare etj:Prodhime materialesh inerte , element betoni, betonarme etj. Punime karpentieri, druri e metal. Punime restaurimi monumente kulture e vepra arkeologjike. Ndertime civile,ekonomike, rruge, ura, vepra arti, hidraulike, hidroteknike. Rehabilitim kanale kulluese, ujtese. Punime ne siperfaqe te gjelberta, parqe e pyll-parqe. • Studime e projektme ne fushen e ndertimit, punimeve pyjore dhe zbatim I tyre si: Projektim ndertesash shumekateshe, projektim peisazhe, siperfaqe te gjelberta, pyje, parqe, linja elektrike, nenstacione, impiante te prodhimit te energjise elektrike, sinjalistike rrugore, rrjete te lekomunikacioni, instalim rrjeti urban, ashensore, sistem ajrimi, ngrohje e ftohje. Permirosime pyjore, pyllezime e kullota. • Tregetim mallrash dhe shitje me shumice dhe pakice. •Tregti Brenda dhe jashte vendit I karburanteve te vajrave lubrifikante si dhe transportimi I tyre. Tregtim te materialeve te ndertimit,pjese kembimi per te gjitha llojet e automjeteve.Tregtim me pakice dhe mbushje te bombulave te gazit per familjare,dhe auto,vajrave lubrifikante,Bar-Lavazh, sherbime etj, • Shit – Blerje te pasurive te paluajtshem

Shoqëria ka të drejtën që Brenda kufijve të lejuara nga Legjislacioni Shqiptar, duke përjashtuar cdo qëllim spekulativ, të marrë pjesë në fitime dhe/ose në shoqëri të tjera të së drejtës apo të shteteve të tjera.



NENI 3
SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqerise do te jete ne Adresen Rr.Autostrada Tirane-Durres Km 3,rruga dytesore,Zona Industriale.

KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e SHOQËRISË është me afat të pacaktuar.

NENI 5
PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitet juridik në ditën e regjistrimit në Q.K.B, ndërsa veprimtaria e saj fillon me regjistrimin në organet tatimore.Dhe ne momentin e marrjes se licenses ne organet perkatese te licensimit per ato veprimtari qe kerkohet licence

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar I SHOQËRISË është 100 000 (njëqindmijë lek).Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:


OrtakuThemelues Z. Pjeter Lamthi zotërues

I nje(1) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lek që përbën 100% tëkapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar mund edhe të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë. Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet me vendim të ORTAKUT TË SHOQËRISË.

NENI 7
VEPRIMET FINANCIARE

Veprimet financiare të SHOQËRISË pasqyrohen në llogaritë (kontabilitetin) e saj duke aplikuar kriteret e dispozita mbi kontabilitetin e Shoqërive Tregtare tëparashikuar në legjislacionin shqiptar.



Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit themeltar bëhet me vendim të ORTAKUT TË SHOQËRISË.

Fondi me të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar për llogari të shoqërisë në Bankën e Kursimeve, Banka Raiffeisen. etj

NENI 8 BLERJET E SHOQËRISË

SHOQËRIA disponon dhe gëzon pasurinë e saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e themelimit të saj. SHOQËRIA ka të drejtën e blerjes dhe administrimit të pasurisë të cdo lloj e natyre si edhetë jape garanci si mjet sigurimi mbi pasuritë e saj përpërbushjen e detyrimeve që merr përsipër kundrejt të tretëve.

NENI 9 ADMINISTRIMI I shoqërisë

Shoqëria do të administrohet nga zoti Pjeter Lamthi, në përputhje me Statutin dhe dispozitat respektive të Ligjit 9901" Për Shoqëritë Tregtare dhe tregëtarët". Administratori është i zgjedhur për 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë private që shoqëron këtë Akt Themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me organet shtetërore, personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- a) Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke I kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) Të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) Të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personal me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



NENI 10

SHËNDRRIMI SHOQËRISË

SHOQËRIA mund të shëndrrohet në një shoqëri anonime me vendim e ORTAKUT dhe në përputhje me Legjislacionin Tregtar Shqiptar.

NENI 11

PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria prishet në rastet kur:

- a) Mbaron afati I përcaktuar në Akt-Themelim;
- b) Nuk mund të realizohet objekti I SHOQËRISË sipas Aktit të Themelimit dhe Statutit;
- c) Një vendim të tillë I marrë nga ORTAKU I SHOQËRISË;
- d) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- e) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723,
- f) Me vendim të gjykatës;
- g) Për arsye të tjera, të parashikuara në statut;

NENI 12

HYRJA NË FUQI

Ky AKT THEMELIMI hyn në fuqi ditën e regjistrimit të SHOQËRISË NË Q.K.B. Ky AKT THEMELIMI u njoh dhe u nënshkrua nga ORTAKU I shoqërisë në Tirane, Me date; 06.02.2020

ORTAKU I SHOQËRISË “CONSTRUCTION TECHNOLOGY ” sh.p.k

Z. Pjeter Lamthi



